

VENDIM
Nr. 453, datë 27.5.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR ORGANIZIMIN E
AKTIVITETEVE NË KUADËR TË NISMËS “LUTJA E PAQES 2015”, NË
BASHKËPUNIM ME KOMUNITETIN SANT’EGIDIO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të nenit 2, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant’Egidio-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri, ratifikuar me ligjin nr. 9628, datë 30.10.2006, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, t’i shtohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, për organizimin e aktiviteteve në kuadër të nismës “Lutja e Paqes 2015”, në bashkëpunim me Komunitetin Sant’ Egidio.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama